

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI JURIDIK – STUDIMET MASTER
ABSTRAKT

Tema: Njohja e drejtës së huaj, rast studimi Kosova

Ky punim trajton çështjen e njohjes së drejtës së huaj në kontekstin juridik të Kosovës. Fokus kryesor është mënyra se si sistemi juridik kosovar trajton dhe aplikon normat dhe ligjet e huaja, sidomos në raste me element ndërkombëtar, siç janë marrëdhëniet kontraktore, familjare dhe tregtare me shtete të tjera. Punimi analizon kuadrin ligjor të Kosovës për njohjen e ligjeve të huaja, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe aktet vendore, duke përfshirë Kushtetutën dhe Ligjin për të drejtën ndërkombëtare private.

Shqyrton kornizën ligjore dhe praktikën e zbatimit të së drejtës së huaj në Kosovë, duke përfshirë analizën e rasteve specifike gjyqësore dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Gjithashtu në këtë studim diskutohet roli i gjykatave dhe autoriteteve kosovare në procesin e njohjes dhe sfidat me të cilat përballen, si dhe ofrohen rekomandime për përmirësimin e kornizës aktuale ligjore në Kosovë për të lehtësuar njohjen e vendimeve dhe normave të huaja.

Në fund, propozon rekomandime për përmirësimin e qasjes së Kosovës ndaj të drejtës së huaj, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe harmonizimit të sistemeve juridike.

Fjalët kyçe: E drejta e huaj, njohje e ligjeve, e drejtë ndërkombëtare private, Kosova, konflikt i ligjeve.

Mentore:

Prof. Donikë Qerimi

Kandidate:

Kujtesa Kralani